

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL

KOLEGJI I APELIT TË AKP-së

ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-2/10

Prishtinë

7 korrik 2011

Në procedurën e

A.J.

Paraqitësi i kërkeses/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Kryetarja e Kolegjit Antoinette Lepeltier-Durel, si dhe nga Gjyqtarët Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, duke vendosur me ankesën e ushtruar kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KKPK/D/A/29/2008 (dosja e regjistruar në AKP si KPA01403), e datës 19 dhjetor 2008, KKPK/D/A/22/2008 (dosja e regjistruar në AKP si KPA01402), e datës 28 gusht 2008, dhe KKPK/D/A/25/2008 (dosja e regjistruar në AKP si KPA01396), e datës 23 tetor 2008, pas seancës gjyqësore të datës 12 korrik 2011, merr këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e ushtruara nga A.J. të ushtruara kundër vendimeve KKPK/D/A/29/2008, të datës 19 dhjetor 2008, KKPK/D/A/22/2008, të datës 28 Gusht 2008, dhe KKPK/D/A/25/2008, të datës 23 tetor 2008, hudhen poshtë si të papranueshme.
- 2- Shpenzimet e procedurës në shumë prej € 55 (pesëdhjetëpesë euro) do të mbulohen nga ankuesi, A.J., dhe do të paguhen në Buxhetin e Kosovës mbrenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e dërgimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Historiku faktik dhe procedural:

Me datë 5 dhjetor 2007, A.J. ka paraqitur kërkesë në Agjencionin Kosovar të Pronës (KKPK), duke pretenduar se ai është pronar e palujtshmërisë kontestuese dhe kërkuar riposedimin e këtyre ngastrave kadastrale:

me kërkesën nr. KPA01403 ai ka kërkuar riposedimin mbi parcelen kadastrale nr. 1649/8 në sipërfaqe prej 0.34.00 ha, në Bresje, Komuna e Fushë Kosovës; me kërkesën nr. KPA01402 ai ka kërkuar riposedimin mbi ngastren kadastrale nr. 1536/58 në sipërfaqe prej 0.74.99 ha, në vendin e quajtur “Jagnela”, arë e klasit të 3; dhe me kërkesën nr. KPA01396 ai ka kërkuar riposedimin e ngastrës kadastrale nr. 2426 dhe 2427 në vendin e quajtur “Latkovica”, kulturë: kullosë, respektivisht arë e klasit të 3, në sipërfaqe prej 0.91.28 ha.

Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës i ka ofruar AKP-ës midis tjerash edhe listen poseduese 1934 të datës 8 nëntor 2007 të Zyrës Kadastrale në Fushë Kosovë, duke vënë në pah se ngastra kadastrale e sipërcekur nr. 1649/8 ishte në posedimin e J.A., dhe certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-7251403600779 të datës 18 Qershor 2008 lëshuar nga Zyra Kadastrale e Fushë Kosovës, e cila i deklaron ata si pronar të parcelave 1536/58, 2426 and 2427 J.N. dhe J.A., secilin nga ata në $\frac{1}{2}$ e pjesës ideale. Dokumentet janë verifikuar nga AKP-ja.

Me vendimet KKPK/D/A/29/2008, të datës 19 dhjetor 2008, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka vendosur se paraqitësi i kërkesës A.J. ishte pronar i parcelës së sipërpërmendur 1649/8 dhe se ai ka pasur të drejtën e posedimit mbi këtë palujtshmëri në fjalë. Me vendimin KKPK/D/A/22/2008, të datës

28 Gusht 2008, KKPK-ja ka vendosur që paraqitësi i kërkesës A.J. ishte pronar në 1/2 e parcelës 1536/58 dhe se ai kishte posedimin mbi këtë palujtshmëri. Me vendimin KKPK/D/A/25/2008, të datës 23 Tetor 2008, ishte vendosur që paraqitësi I kërkesës ishte pronar në 1/2 e parcelës së sipërpërmendur 2426 dhe 2427 dhe se ai kishte posedimin mbi këtë palujtshmëri.

Paraqitësi i kërkesës (tani e tutje: ankuesi) ka pranuar vendimet e KKPK-ës të datës 23 Pril 2009. Me 21 Maj 2009 ai ka ushtruar ankesë kundër të tri vendimeve. Në lëndën GSK-KPA-A-2/10 (KPA01403) ka argumentuar se pronari i pishinës "PISHINA" kishte hapur kanal in për ujë, kështu që uji nuk ka mundur të shterrojë-largohet nga toka e tij në raste të shirënjës. Në rastin GSK-KPA-A-3/10 (KPA01402) ai ka argumentuar se rrethoja në palujtshmërinë e tij e ndërtuar nga Universiteti AAB duhet të largohet. Në rastin GSK-KPA-A-4/10 (KPA01396) ai ka argumentuar se ndërtimi I vëqantë I madh ka bllokuar rrugën drejt tokës së tij dhe se tubacionet e ujit janë bllokuar.

Meqenëse gjatë procedurës së zhvilluar pranë AKP-ës nuk ka pasur identifikim të palës përgjegjëse në kërkesë vendimi I KKPK-ës nuk I është dorëzuar asnjë individ i përveq ankuesit, ish paraqitësit të kërkesës.

Gjykata ka pranuar ankesat me datë 15 prill 2010 dhe i ka bashkuar ato.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paraqitësit të kërkesës është e palejueshme.

Nga lënda shihet se ankuesi ka kaerkuar të drejtën e pronësisë dhe posedimin në parcelen kontestuese.. KKPK ka vendosur në favor të paraqitësit të kërkesës duke i njohur të drejtën e pronësisë dhe duke i njohur posedimin (shiko nenin 11.2 të Rregullores së UNMIK 2006/50 e amandamentuar me Ligjin nr. 03/L-079). Me vendimin e tij KKPK-ja ke vendosur në tërësi për atë çfarë në të vërtetë ka kërkuar ankuesi në kërkesen e tij. Në përputhshmëri me dispozitat ligjore të nenit 14, 15 dhe 16 të Rregullores 2006/50 e amandamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, aim und të kërkoj nga AKP-ja përmbarrimin e vendimeve.

Në arsyetimin e tij në ankesë, ankuesi nuk ofron ndonjë fakt që do të vënte në pah se kërkesa e paraqitur nga ai nuk është pranuar në tërësi nga ana e KKPK-ës.

Meqenëse kërkesa e paraqitur nga ana e ankuesit është pranuar në tërësi, ankuesi nuk ka interesin juridik për parashtrimin e ankesës. Në përputhshmëri me nenin 186.3 të Ligjit Për procedurën kontestimore ankesa

duhet të hedhet poshtë si e palejueshme nëse personi I cili ka ushtruar ankesën nuk ka më interesin juridik për ushtrimin e ankesës.

Më tutje ankuesi gjatë paraqitjes së pretendimeve të tija nuk ka paraqitur ndonjë fakt që tregon se pengimi i pretenduar ishte rezultat direkt i rrethanave apo pasojave të konfliktit të armatosur që kishte ndodhë 27 shkurt 1998 dhe 20 Qershorit 1999, ashtu siq është paraparë me dispozitat ligjore të nenit 3.1 nënparagrafi “a” dhe “b” të Rregullores së of UNMIK 2006/50 e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079. KKPK-ja dhe AKp-ja, sidoqoftë kanë jurisdiksion vetëm për rastet që kanë të bëjnë me konfliktin. Prandaj, ankesa duhet të hidhet gjithashtu edhe për shkak të mungesës së jurisdiksionit. Nga e gjithë kjo, shihet se ankuesi nuk ka interes për ushtrimin e ankesës në fjalë sipas nenit 186 paragrafi 3 i LPK-ës, ashtu siq është vendosur në dispozitivin e këtij aktgjykimi në përputhshmëri me nenin 13.3 nënparagrafi “b” i Rregullores së UNMIK 2006/50 e amendamentuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

Shpenzimet gjyqësore:

Sipas Nenit 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët përjashtohen nga shpenzimet e procedurës pranë Sekretariatit Ekzekutiv dhe Komisionit.

Mirëpo, një përjashti kësaj nuk parashihet për procedurën pranë Kolegjit të Apelit.

Si pasojë, për procedurën e sjellë pranë Kolegjit të Apelit, aplikohet regjimi normal i taksave gjyqësore, siç parashihet me Ligjin për taksat gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Shpenzimeve Gjyqësore.

Pra, për këtë procedurë ankimimi, aplikohen këto shpenzime gjyqësore::

- Për paraqitjen e ankesës, tarifa e shpenzimeve gjyqësore (Neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Gjysma e taksës gjyqësore nga tarifa e shpenzimeve gjyqësore (Nenet 10.15, 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e kësaj pasurie, sipas kontratës së palëve mbi shitblerje është € 5001 dhe 10000: € 25.

Këto shpenzime gjyqësore i paguan ankuesi i cili e humb çështjen. Afati për pagim është paraparë në nenin 45.1 të Ligjit Mbi Shpenzimet Gjyqësore. Si pasojë e mos pagesës mbrenda afatit, mund që të urdhërohet ekzekutimi i detyrueshëm duke përfshirë edhe gjobën ashtu siq është parashikuar me nenin 47 të të njejt ligji.

Sipas Nenit 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati i fundit për pagesën e shpenzimeve nga një person me vendbanim jashtë vendit, nuk mund të jetë më pak se 30 dhe më shumë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendosë që, në këtë çyshtje, shpenzimet gjyqësore duhet ti paguaj i padituri brenda 90 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Këshillë juridike

Sipas Nenit të Rregullores së UNMIK-ut 13.6 of UNMIK 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotëfuqishëm dhe i formës së prerë, e cili nuk mund të kundërshtohet me mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Antoinette Lepeltier-Durel, EULEX Presiding Judge

Anne Kerber, EULEX Judge

Sylejman Nuredini, Judge

Holger Engelman , EULEX Registrar